



STUDIO LEGALE
AS&T
Aviation Shipping & Trade

Inkoterms: Struktura,
Funkzioni,
Problemet Operative

1. Prej 70 viteve tashmë, inkotermat përfaqësojnë një mjet të një rëndësie të veçantë për ndërmarrjet që operojnë në tregtinë ndërkombëtare. Botimi i fundit është ai i 1 janarit 2000.

2. Kemi të bëjmë me sistemin e rregullave të kodifikuara nga Dhoma e Tregtisë Ndërkombëtare për interpretimin e termave tregtare, që i ofrojnë operatorëve një sistem të shpejtë për përcaktimin në mënyrë të saktë të detyrimeve që lindin në fushën e kontratave të shitjes ndërkombëtare.

3. Me anë të inkotermave, përmbliidhen dhe përcaktohen, disa nga më të përdorurat klauzola kontraktuale, të përdorura në tregtinë ndërkombëtare për të disiplinuar:


- kostot e transportit,
- momentin e dorëzimit të mallit,
- kostot e sigurimeve,
- transferimin e rreziqeve për humbjen ose dëmtimin e mallit përgjatë kryerjes së transportit.

4. Duhet pasur parasysh se Inkotermat nuk merren me disiplinimin e kalimit të pronësisë për mallin e shitur.

5. Transferimi i pronësisë për ligjin shqiptar dhe ndërkombëtar është i disiplinuar nga Kodi Civil dhe kryet sipas mënyrave të mëposhtme:

- Transferimi i pronësisë për efekt të konsensusit të palëve.
- Shitja e sendeve të përcaktuara vetëm në përgjithësi (p.sh. një sasi gruri për ton): transferimi i pronësisë me përcaktim, që në rastin kur malli transportohet, realizohet vetëm me dorëzimin e tij tek transportuesi ose tek spedicioneri.

Inkotermet e vitit 2000 janë ndarë në 4 grupe duke përdorur germën e parë si tregues të grupit të cilit i përkasin.



6. Grupi E – Shpërndarja

- Ex Works - EXW (...vendi i caktuar)

“Ex Works” Shitësi vendos mallin në dispozicion të blerësit aty ku e ka marrë përsipër ose në një vend tjetër të caktuar.

Detyrimet për shitësin në këtë rast janë minimale, për faktin se ai limitohet vetëm të verë në dispozicion sendin e shitur në brendësi të ambienteve të ndërmarrjes së tij.

Grupi F
Transportuesi
Kryesor
i papaguar
nga shitësi

FCA

Transporti i Lirë

FAS

I lirë në krah të
Anijes (Porti
i anijes i
përcaktuar).

FOB

I lirë në bord
të anijes.

7. Grupi F (klauzolat FCA, FAS dhe FOB).

- Përfshin (FCA,FAC,FOB) që tregojnë se shitësi duhet të dorëzojë mallrat tek një transportues i përcaktuar, të lira nga risku dhe shpenzimet për blerësin.
- Përmbledh paktet me anë të të cilëve parashikohet që Blerësi të paguajë transportin për itinerarin kryesor dhe gjithashtu të marrë përsipër rreziqet për humbjen e mallit nga momenti që malli i dorëzohet transportuesit.

Grupi C

Trasportuesi kryesor i paguar nga Shitesi

CFR

Kostoja dhe qeraja e transportit (porti i destinacionit i caktuar)

CIF

Kosto Sigurimi dhe qeraja e transportit

CPT

Transporti i paguar tek (.vendi i destinacionit i përcaktuar)

CIP

Transporti dhe sigurimet paguhen në destinacion

8. Grupi C (klauzolat CFR, CIF, CPT e CIP)

- Mbi Shitësin rëndon kostoja e transportit (dhe eventualisht edhe mbulimi me siguracion), por nuk përfshihen rreziqet e humbjeve dhe/ose të avarive, të cilat janë në ngarkim të Blerësit, pas kalimit të mallit në bordin e anijes në portin e ngarkimit.

Grupi D Mbërritja

DAF

Dorëzimi
deri në kufi.
(.Vendi i
destinacionit
i Përcaktuar)

DES

Dorëzimi deri
në Anije
(porti i
destinacionit
i përcaktuar)

DEQ

Dorëzimi
deri
në kalatën
e portit
dest.
i përcaktuar)

DDU

lëvruar malli
pa paguar
dogane

DDP

Duke paguar
doganën.
Shitësi
dërgon
mallin tek
blerësi

9. Grupi D (DAF, DES, DEQ, DDU e DDP)

- Detyrimet e ndërmarra nga Shitësi janë maksimale, duke qenë ky i fundit i detyruar të ndërmarrë përsipër kostot dhe rreziqet e transportit deri në destinacion.

10. Zakonisht bëjmë dallim midis kontratave "në mbërritje" dhe kontratave "në nisje".

11. Termat e Grupit F dhe C kanë një natyrë të njëjtë (dhe kemi të bëjmë gjithmonë me kontrata "në nisje") duke konsideruar faktin se në të dy rastet, detyrimet e Shitësit përmbushen të gjitha në vendin e ngarkimit (nisjes) së mallit.

12. Në të kundërt, në kontratat e Grupit D (kontrata në mbërritje), i kërkohet Shitësit që të mbulojë gjithashtu kostot edhe në vendin e mbërritjes;

- kështu p.sh., në rast se realizohet një shitje me termat DDP (më pak e favorshme për Shitësin), ky i fundit do të jetë i detyruar që të mbulojë kostot e transportit deri në dorëzimin e mallit në destinacion, duke përfshirë gjithashtu edhe taksat për “zhdoganim” të mallrave dhe çdo shpenzim tjetër për të përfunduar transportin në vendin e Blerësit.

13. Sigurimi i mallit

- Janë vetëm dy Inkoterma të cilat kompletojnë siguracionin, që do të thotë termat CIF dhe CIP, të cilët nënkuptojnë se është Shitësi i cili duhet të mbulojë siguracionin në favor të Blerësit.

Të dy këto Inkoterma parashikojnë një detyrim për mbulim minimal me siguracion, si p.sh., Në kushtet ICC(C) – është e padobishme për shitjen e produkteve për të cilat ekzistojnë rreziqe si vjedhje, ose Manipulime, për të cilat këshillohet një mbulim me siguracion më të madh.

14. Krahasimi midis ICC (C) dhe ICC (A)

ICC (C) mbulojnë vetëm humbjet dhe dëmtimet e mallit të cilat shkaktohen si rrjedhojë e zjarreve, shpërthimeve, bllokimeve dhe përmbytjeve të anijeve ose dhe të përmbysjeve të mjeteve transportuese tokësore, përplasje dhe shkarkim në portin e ndërmjetëm më të afërt. ICC (A) janë "all risks".

15. Inkotermat janë gjithmonë të lidhura ngushtë me ligjin e aplikueshëm të kontratës.

- Kemi të bëjmë me një normative uniforme (si p.sh., Konventa e Vjenës e 1980, mbi shitblerjen e pasurive të luajtshme, ose Konventa e Aja-s, e vitit 1964), ose me ligjin e vendit të njërit prej dy kontraktorëve, ose me ligjin e vendit të përzgjedhur nga palët.

AS&T
aviation shipping & trade



STUDIO LEGALE ASSOCIATO DI DIRITTO
DEI TRASPORTI E DEL
COMMERCIO INTERNAZIONALE

JU FALENDEROJME PER VEMENDJEN

AS&T Legal Albania

www.astlegal.com

Adresa: Durrës (AL),
Lagja nr. 1 Sheshi Taulantia.
Tel: +355 52 35860
Fax: +355 52 24293

Filialet: Bologna – Milano – Roma – Ravenna – Torino – Venezia